

STATUT DHE AKT-THEMELIMI I SHOQËRISË "ALCON ADMINISTRIM" SHPK

Sot me datë 03.08 2025 (dymije e njezete e pese), shoqëria "ALCON" sh.p.k regjistruar me datë 26.04.1995 ne QKB(Qendra Kombetare e Biznesit) me NUIS J64102266A, dhe objekt aktiviteti ne fushen e ndertimit, ne zbatim, mbikqyrje, kolaudim etj., me perfaqesues ligjor Z.Besnik Hysenbelli, i datelindjes 19.01.1972, lindur ne Potom, Skrapar dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin ID: H20119030N, krijon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar " ALCON ADMINISTRIM" sh.p.k sipas termave dhe kushteve si me poshte vijon:

TITULLI I EMRI I SHOQERISE - REGJIMI JURIDIK - SELIA - KOHEZGJATJA

Neni 1 - Emri i Shoqerise

- 1.1 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria do të emërohet "ALCON ADMINISTRIM" sh.p.k ne vijim referuar si "Shoqëria".
- 1.2 Shoqëria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.

Neni 2 - Regjimi Juridik i Shoqerise

- 2.1 "ALCON ADMINISTRIM" sh.p.k eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
- 2.2 Aktiviteti i saj do të organizohet sipas dispozitave te Statutit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil ne Republiken e Shqiperise.
- 2.3 Shoqëria mund të ndryshojë regjimin e saj juridik me vendim të ortakut të vetëm, në përputhje me ligjin
- 2.4 Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

Neni 3 - Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Pallati ALCON, Rruga "Inajete Dumi" dhe "Mustafa Mara", Nj.Strukture TR/61, Tiranë ,Shqiperi.
- 3.2 Shoqëria mund te hape ose te mbylle dege, filiale dhe / ose zyra perfaqesimi brenda Shqiperise dhe / ose jashte vendit, ose te krijojë shoqeri te tjera me Partnere apo Aksionare pjesemarres sipas nevojave të saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4 - Kohezgjatja

- 4.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortaku i vetëm mund të vendosë kufizimin e kohëzgjatjes me vendim.



TITULLI II OBJEKTI

Neni 5 - Objekti

- 5.1 Shoqëria "ALCON ADMINISTRIM " sh.p.k. do të ushtrojë aktivitetin e saj vetëm në fushën e administrimit të objekteve në bashkëpronësi.
- 5.2 Shoqëria mund të ndryshojë ose zgjerojë objektin e saj të veprimtarisë me vendim të ortakut të vetëm dhe në përputhje me ligjin në fuqi.

TITULLI III KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali i Shoqerise

- 6.1 Kapitali fillestar i shoqërisë është **100 (njeqind) lekë** dhe është i zotëruar 100% nga shoqëria "ALCON" sh.p.k.
- 6.2 Kapitali mund të rritet ose zvogëlohet me vendim të ortakut të vetëm dhe në përputhje me ligjin.
- 6.3 Kontributi në kapital mund të jetë në para, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme ose të drejta pasurore të vlerësuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 7 - Transferimi i kuotave

- 7.1 Kuotat e shoqërisë mund të transferohen vetëm me vendim të ortakut të vetëm dhe sipas procedurave ligjore në fuqi.
- 7.2 Shoqëria nuk mund të pranojë ortakë të rinj pa miratimin e ortakut të vetëm.

TITULLI IV ADMINISTRIMI DHE PËRFAQËSIMI

Neni 8 - Administratori

- 8.1 Shoqëria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një Administrator, i cili mund të jetë ose jo ortak.
- 8.1 Administratori do të jetë **Pëllumb Hysenbelli** me nr. personal ID: I00820003S i lindur me 20.08.1980 ne Potom, Shqiperi dhe ka kompetencat e plota për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha veprimet juridike dhe administrative. Ky emerim prodhon efekte ligjore ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- 8.2 Mandati i Administratorit është **5 (pese) vjecar** me mundësi rinovimi sipas vendimit të ortakut të vetëm.



- 8.3 Në rast dorëheqjeje, shkarkimi apo paaftësisë së Administratorit, ortakut i vetëm emëron një administrator të ri.
- 8.4 Administratori ka për detyrë të veprojë në interesin më të mirë të shoqërisë dhe të zbatojë vendimet e ortakut të vetëm.
- 8.5 Administratori i shoqërisë ka të drejtën dhe detyrimin për të përfaqësuar Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet.
- 8.6 Ortaku i vetëm ka të drejtë të ushtrojë kontroll mbi administrimin dhe aktivitetin financiar të shoqërisë, si dhe të kërkojë raporte periodike nga administratori.

Administratori ushtron keto detyra:

- a) **Përfaqësimi i Shoqërisë:** Administratori ka kompetencën për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha veprimet juridike dhe administrative, si dhe në marrëdhëniet me palë të treta.
- b) **Përmbushja e Detyrimeve Ligjore dhe Tatimore:** Administratori duhet të sigurojë që shoqëria të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore dhe tatimore, duke përfshirë pagesën e taksave dhe dorëzimin e dokumenteve të kërkuara nga autoritetet kompetente.
- c) **Zbatimi i Vendimeve të Ortakut të Vetëm:** Administratori është i detyruar të zbatojë vendimet dhe politikat që miraton ortakut i vetëm, duke siguruar se ato implementohen në mënyrë efektive.
- d) **Rikapitalizimi dhe Ndryshimet në Kapital:** Nëse është e nevojshme, administratori mund të nxisë ndryshime në kapitalin e shoqërisë, në përputhje me kërkesat e ortakut të vetëm.
- e) **Menaxhimi i Aktivitetit të Shoqërisë:** Administratori është përgjegjës për menaxhimin dhe organizimin e veprimtarive të përditshme të shoqërisë, përfshirë administrimin e objekteve në bashkëpronësi.
- f) **Emërimi dhe Mbikëqyrja e Personelit:** Nëse ka staf të punësuar, administratori mund të jetë përgjegjës për rekrutimin dhe mbikëqyrjen e personelit të shoqërisë, si dhe për menaxhimin e marrëdhënieve të punës.
- g) **Menaxhimi i Konfliktëve dhe Paaftësisë:** Administratori duhet të trajtojë çdo çështje të mundshme konflikti dhe të sigurojë zgjidhjen e saj në përputhje me ligjin dhe interesat e shoqërisë.
- h) **Menaxhimi i Shërbimeve të Mirëmbajtjes**
 - Organizimi dhe mbikëqyrja e pastrimit të ambienteve të përbashkëta.
 - Kontrolli dhe sigurimi i mirëmbajtjes së ashensorëve, ndriçimit, sistemit të ujit dhe kanalizimeve.
 - Koordinimi i riparimeve të vogla dhe ndërhyrjeve emergjente.
 - Mbikëqyrja e gjelbërimit dhe ambienteve të jashtme.
- i) **Administrimi Financiar**
 - Mbledhja e kuotave mujore nga banorët për mirëmbajtjen.
 - Menaxhimi i shpenzimeve dhe përpilimi i raporteve financiare.
 - Mbajtja e marrëdhënieve me furnitorët dhe nënkontraktorët për shërbimet e mirëmbajtjes.



- Zbatimi i transparencës në përdorimin e fondeve të përbashkëta.

j) **Zbatimi i Rregulloreve dhe Ligjeve**

- Sigurimi që mirëmbajtja e ndërtesës respekton rregullat dhe standardet e sigurisë.
- Koordinimi me institucionet shtetërore për certifikatat e sigurisë (p.sh., për ashensorët).
- Hartimi dhe përditësimi i rregulloreve të brendshme për përdorimin e hapësirave të përbashkëta.

k) **Komunikimi me Banorët**

- Informimi i banorëve për ndryshimet në tarifat e mirëmbajtjes ose projektet e reja.
- Organizimi i mbledhjeve me banorët për të adresuar shqetësimet e tyre.
- Trajtimi i ankesave dhe konflikteve në mënyrë profesionale.

l) **Monitorimi i Sigurisë**

- Sigurimi i funksionimit të sistemit të kamerave ose rojeve të sigurisë, nëse ka.
- Kontrolli i hyrjeve/daljeve në ambientet e përbashkëta.
- Mbikëqyrja e kontratave për shërbimet e sigurisë, nëse ka.

m) cdo detyrë tjetër siç percaktohet me ligj ose Statut.

TITULLI V VITI FINANCIAR, DIVIDENTI

Neni 9 - Viti Financiar

9.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të çdo viti.

9.2 Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit ne QKB dhe perfundon me 31 dhjetor te atij viti.

Neni 10 – Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve

10.1 Dividenti shpërndahet sipas vendimit të ortakut të vetëm, nëse plotësohen kushtet ligjore.

10.2 Me vendim të ortakut, fitimet mund të kapitalizohen.

TITULLI VI SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI

Neni 11 - Prishja-Ndarja-Bashkimi

11.1 Shoqëria mund të shpërbehet, ndahet, bashkohet me vendim të ortakut të vetëm ose në raste të parashikuara nga ligji.

Neni 12 – Likuidimi

17.1 Ne rast te prishjes shoqeria mund te likuidohet dhe ortaku i vetëm cakton një likuidator dhe vendos mbi shpërndarjen e aseteve të mbetura pas shlyerjes së detyrimeve.



17.3 Ne fund te procedurave te likuidimit, ortaku i vetem do te vendose ne lidhje me bilancin perfundimtar, punen e bere nga likuiduesi dhe te perfundoje procesin e likuidimit.

Dispozita te Fundit

Ky Statut u hartua ne date 03.03.2025, ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.


Ne deshmi te kesaj, une i nenshkruari Noteri Publik vertetoj nenshkrimin e ortakeve te shoqerise perpara meje, qe teksti i ketij akti eshte ne perputhje me vullnetin e tij dhe e nenshkruaj ate vullnetarisht ne pranine time dhe une, noteri publik, vertetoj se sa me lart eshte ne perputhje me ligjin ne fuqi.


ORTAKU THEMELUES

Shoqëria "ALCON" sh.p.k

Administrator Besnik Hysenbelli

Besnik Hysenbelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



V2025053790133737023

DATE 03/03/2025

NR REP 1954

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 03.03.2025 (dymije e njezete e pese), vërtetoj nënshkrimin e ortakut themelues të Shoqërisë "ALCON ADMINISTRIM" SHPK, Shoqëria "ALCON", shpk, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS J64102266A, me adresë Mjull Bathore, Kompleksi "the Touch Of Sun", Sauk, përfaqësuar nga Administratori Besnik Hysenbelli, atësia Hasan, amësia Fiqirete, shtetas Shqiptar, lindur në Potom, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë Vaso Pasha; Nd. Pall.10k; Ap. 8; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 19/01/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034346534 dhe nr. personal H20119030N. I cili me ka deklaruar se Akti është nënshkruar prej tij dhe Unë Noteri/j, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MAJLINDA DEMOLLARI

NOTER
Majlinda E. Demollari
MPP, K416060404
Tel. 0688061569

F_2^2 δ^i